

VENDIM
Nr.3, datë 20.10.2006

PËR PËRJASHTIMIN NGA AKCIZA E KARBURANTIT TË PËRDORUR NË LINJAT E
AGROPËRPUNIMIT

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2006, shqyrtoi raportin “Për përjashtimin nga akciza e karburantit të përdorur në linjat e agropërpunimit”. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me shkresën nr.2029, datë 24.7.2006 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.AI/010/2005.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, mbështetur në nenin 2 shkronja 2 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”,

VENDOSI:

Skema e dhënë nuk bie në fushën e zbatimit të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”.

Në kuadër të detyrimeve të MSA-së dhe Marrëveshjes së OBT-së, Komisioni i Ndihmës Shtetërore

REKOMANDON:

1. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit duhet të bëjë një klasifikim të saktë të subjekteve përfituese mbi bazën e nënsektorëve të veçantë.

2. Llogaritja e intensitetit të skemës të bëhet duke iu referuar treguesve të GDP-së të secilit prej nënsektorëve, duke mos kaluar në asnjë rast kufirin prej 5% të përcaktuar në Marrëveshjen e OBT-së.

3. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit duhet të marrë parasysh vlerën kumulative të të gjitha skemave të ndihmës që jepen në sektorët e bujqësisë, pasi kufiri prej 5% përfshin të gjitha format e ndihmës për këta sektorë.

KRYETARI
Genc Ruli